EPOKA E RE
E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8341
E enjte, 16 korrik 2026
Çmimi 0. 50 €

## Merr detyrën kryeprokurori i ri i shtetit, Zejnulla Gashi

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

# GLPS DHE KDI U BËJNË THIRRJE PARTIVE POLITIKE: KA ARDHUR KOHA PËR KOMPROMIS DHE FUNKSIONALIZIMIN E INSTITUCIONEVE

FAQE 4-5



Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), duke marrë parasysh krizën e thellë politike dhe institucionale që e ka karakterizuar vendin për pothuajse dy vjet, u kanë bërë thirrje partive politike parlamentare të ndërmarrin, pa vonesë, hapat e nevojshëm për konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë. Sipas këtyre dy organizatave, konsensusi politik nuk duhet të perceptohet si shenjë dobësie politike, por si dëshmi e pjekurisë demokratike dhe e përgjegjësisë ndaj qytetarëve

## DORËZOHEN NËNSHKRIMET PËR KUVEND TË JASHTËZAKONSHËM TË LDK-SË MES THIRRJEVE PËR SHKARKIMIN E ABDIXHIKUT

F. 5



## KOSOVA E SHPALL MINISTREN SERBE PERSON 'TË PADËSHIRUESHËM' PAS DEKLARATAVE TË SAJ PËR 'SPASTRIM ETNIK'

F. 3



## AKTUALE




### SENATI AMERIKAN SJELL PROJEKTLIGJIN E RISHIKUAR PËR SANKSIONET NDAJ RUSISË

F. 2

### HAXHIU DHE KURTI PRESIN SEKRETARIN E PËRGJITHSHËM TË OSBE-SË, KËRKOJNË ROL MË TË MADH TË KOSOVËS NË FORUMET NDËRKOMBËTARE

F. 7

### DEKLARATA SKANDALOZE E MINISTRES SERBE, AHMETI: ËSHTË TRONDITËSE, ÇNJERËZORE DHE E PAPRANUESHME

F. 3

## EKONOMI




### 'TRAINKOS'-i VË NË FUNKSION PESË VAGONË TË RINJ

F. 8

### OEK: DEFICITI TREGTAR I KOSOVËS ME SHBA-NË U RRIT PËR 21.9 PËR QIND GJATË VITIT 2025

F. 8

## SPORT



### FC DRITA ELIMINOHET NGA LIGA E KAMPIONËVE

F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# SENATI AMERIKAN SJELL PROJEKTLIGJIN E RISHIKUAR PËR SANKSIONET NDAJ RUSISË




**Uashington, 15 korrik** - Një grup senatorësh dypartiakë në Shtetet e Bashkuara e paraqiti më 14 korrik Aktin për Sanksionimin e Rusisë 2026, duke e sjellë një paketë të rishikuar sanksionesh dhe tarifash, synimi i së cilës është t'i godasë financat e luftës së Moskës.

Me projektligjin e ri senatorët synojnë t'i tejkalojnë shqetësimet që kishin bllokuar versionet e mëparshme të legjislacionit.

Projektligji, i cili ka siguruar mbështetjen e më shumë se 26 bashkësponsorëve nga të dyja partitë, ka fituar rëndësi të shtuar politike pas vdekjes së papritur të senatorit Lindsey Graham javën e kaluar, i cili ka qenë njëri prej hartuesve kryesorë të tij.

Lideri demokrat i Senatit, Chuck Schumer nga Nju Jorku, bëri thirrje për votim të menjëhershëm në seancën plenare, duke thënë se legjislacioni duhet të miratohet "në nderim të Lindseyt", ndërsa lideri i shumicës në Senat, John Thune nga Dakota e Jugut, tha se ka "shpreson shumë se mund ta realizojmë këtë".

Ky legjislacion përfaqëson përfundimin e negociatave dypartiake mbi njëvjeçare, dhe vjen pasi Graham kishte njoftuar vetëm një ditë para vdekjes së tij se ligjvënësit kishin arritur marrëveshje me Shtëpinë e Bardhë mbi dispozitat kryesore.

Sipas kolegëve të tij, Graham ishte kthyer nga Ukraina pak para vdekjes dhe kishte biseduar me presidentin amerikan, Donald Trump, për paketën e sanksioneve, duke shprehur optimizëm se administrata më në fund ishte pajtuar me të. "Ai ishte absolutisht i entuziazmuar", tha senatori demokrat Richard Blumenthal nga Konektikati, partneri kryesor demokrat i Grahamit në hartimin e projektligjit, duke folur për bisedën e tyre të fundit. "Nuk e kam parë kurrë kaq të gëzuar". Blumenthal tha se mbështet idenë që legjislacioni ta marrë emrin e Grahamit, duke e quajtur atë "pjesë të trashëgimisë së tij".

### Projektligji zhvendos fokusin te blerësit kryesorë të energjisë ruse

Legjislacioni i rishikuar ndryshon ndjeshëm një propozim të mëparshëm që kishte ngjallur kritika nga ligjvënësit dhe aleatët e SHBA-së, për shkak të shtrirjes së gjerë të dispozitave mbi tarifat. Në vend që të vendosë një tarifë të përgjithshme prej 500 për qind ndaj vendeve që blejnë energji ruse, versioni i ri autorizon tarifa deri në 100 për qind që synojnë pesë blerësit më të mëdhenj të naftës dhe gazit natyror rus, një grup që sponsorët thanë se përfshin Kinën dhe Indinë.

Legjislacioni krijon gjithashtu përjashtime për vendet që importojnë më pak se 15 për qind të eksporteve vjetore të gazit natyror të Rusisë, me kusht që ato të ndërmarrin "hapa të rëndësishëm" për ta ulur varësinë e tyre nga energjia ruse.

Mbështetësit thanë se këto ndryshime janë hartuar për t'i kufizuar pasojat e padëshiruara ekonomike për aleatët e SHBA-së, duke ruajtur njëkohësisht trysninë mbi burimin më të rëndësishëm të të ardhurave të Kremlinit. "Pjesa dërrmuese e të ardhurave të Rusisë, veçanërisht ato që përdoren për luftën e saj agresore në Ukrainë, vjen nga eksportet e naftës dhe gazit rus", tha një zyrtar i Senatit, duke e përshkruar legjislacionin si të hartuar në mënyrë të kujdesshme për të goditur pikërisht këtë sektor.

Përtej tarifave, projektligji detyron vendosjen e sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi kundër presidentit rus, Vladimir Putin, udhëheqësve të lartë politikë dhe ushtarakë, ndërmarrjeve shtetërore, institucioneve financiare, projekteve energjetike, oligarkëve dhe kompanive të huaja që mbështesin bazën industriale të mbrojtjes së Rusisë.

Ai gjithashtu zgjeron sanksionet ndaj të ashtuquajturës "flotë në hije" të Rusisë, e përbërë nga cisterna të vjetra nafte me flamuj të ndryshuar, të përdorura për të shmangur kufizimet ekzistuese mbi eksportet ruse të energjisë.

Krahasuar me versionet e mëparshme, legjislacioni i ri heq formulimin që i bënte sanksionet të kushtëzuara me pjesëmarrjen e Rusisë në negociatat e paqes, duke i bërë shumë prej ndëshkimeve të detyrueshme.

### Fleksibiliteti i Shtëpisë së Bardhë mbetet kompromisi kryesor

Një element kyç i negociatave me administratën Trump u përqendrua në ruajtjen e fleksibilitetit presidencial.

Projektligji i rishikuar i jep presidentit autoritetin për t'i pezulluar sanksionet në rrethana të caktuara, duke pasqyruar shqetësimet e Shtëpisë së Bardhë që pushteti ekzekutiv të ruajë hapësirë veprimi kur kjo i shërben interesave kombëtare të SHBA-së.

Në të njëjtën kohë, negociatorët demokratë siguruan dispozita më të forta mbikëqyrjeje, të cilat kërkojnë që administrata ta njoftojë Kongresin dhe ta justifikojë çdo pezullim të sanksioneve.

Kompromisi erdhi pas muajsh negociatash ku morën pjesë Graham, Blumenthal, senatorja demokrate Jeanne Shaheen nga Nju Hempshire dhe zyrtarë të lartë të administratës, përfshirë sekretarin e Thesarit, Scott Bessent.

Më 14 korrik, Trump tha se legjislacioni ka "shans të mirë" për t'u miratuar, megjithëse sugjeroi shtimin e sanksioneve që synojnë Iranin dhe Hezbollahun. Blumenthal kundërshtoi rihapjen e negociatave, duke thënë se projektligji tashmë kishte miratimin e Shtëpisë së Bardhë dhe duhet të çohet përpara pa ndryshime të tjera.

### Mbështetësit shohin trysni mbi makinerinë luftarake të Kremlinit

Përkrahësit argumentojnë se legjislacioni synon drejtpërdrejt bazën financiare të pushtimit rus të Ukrainës duke goditur të ardhurat nga eksportet e naftës dhe gazit.

"Nëse Kremlini është në gjendje ta financojë makinerinë e tij të luftës përmes shitjes së naftës dhe gazit, ai do të jetë në gjendje ta vazhdojë luftën", tha Shaheen. "Kjo do t'i ndalojë ato blerje. Do ta bëjë të qartë se këto blerje kanë kosto reale".

Blumenthal e përshkroi propozimin si vendosje të "sanksioneve shkatërruese" ndaj Rusisë dhe mbështetësve të saj, ndërsa senatorja republikane Katie Britt nga Alabama tha se Graham besonte se kjo masë do të bëhej "gjëja më domethënëse" që ai kishte arritur gjatë karrierës së tij në Senat.

Senatorët që udhëtuan me Grahamin në Ukrainë javën e kaluar thanë se ai e shihte këtë legjislacion si një pikë kthese që mund të forconte pozitën e Kievit në fushën e betejës dhe në bisedimet e ardhshme për paqen.

Daniel Fried, ish-ndihmëssekretar amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, i cili ka shërbyer nën shtatë administrata, tha se forca më e madhe e legjislacionit të rishikuar qëndron në fokusin e tij më të mprehtë mbi eksportet ruse të energjisë.

"Dispozita më e fortë është Seksioni 113, i drejtuar kundër eksporteve ruse të naftës dhe gazit", i tha Fried Radios Evropa e Lirë. "Ky seksion është më praktik se versioni fillestar, por mund të jetë sfidues për t'u zbatuar. Megjithatë, miratimi i tij mund të sjellë rezultate pozitive në momentin e duhur, duke ushtruar presion mbi Rusinë për t'i dhënë fund luftës", tha ai.

### Kundërshtimi në Dhomën e Përfaqësuesve nxjerr në pah pengesën e parë legjislative

Pavarësisht vrullit të madh në Senat, propozimi përballet me kritika në Dhomën e Përfaqësuesve.

Përfaqësuesi Gregory Meeks nga Nju Jorku, demokrati më i lartë në Dhomë për politikën e jashtme, argumentoi se legjislacioni i jep Trumpit autoritet të tepruar mbi tarifat në vend se të vendosë sanksione automatike ndaj Moskës. "Ky nuk është aq shumë projektligj për sanksione, sa është autoritet i madh i fshehtë që i jepet presidentit Trump për të vendosur tarifa të tjera, përfshirë ndaj aleatëve tanë evropianë", tha Meeks.

Ai paralajmëroi se sanksionet në fund mbeten në diskrecionin e presidentit dhe u bëri thirrje ligjvënësve ta bëjnë në vend të kësaj një legjislacion dypartiak të ndërtuar mbi Aktin për Mbështetjen e Ukrainës, i miratuar nga Dhoma e Përfaqësuesve më herët gjatë këtij viti.

Kritikët theksojnë se, megjithëse mbështetësit në Senat besojnë se janë pranë sigurimit të votave të nevojshme, legjislacioni mund të përballet ende me debate të rëndësishme përpara se të mbërrijë në tryezën e presidentit Trump.

Megjithatë, Blumenthal shprehu besimin se projektligji është pranë miratimit. "Ky projektligj është negociuar për gati dy vjet, me shumë kujdes, e ndonjëherë edhe me shumë vështirësi", tha ai. "Mendoj se i kemi votat".

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

## Rama: Serbia nuk është e gatshme ta pranojë realitetin se nuk ekziston më diçka që quhet Kosovë dhe Metohi, por Republika e Kosovës



PRISHTINË, 15 KORRIK - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë të mërkurën në një intervistë për "Euronews", se Serbia është më përgjegjësja për situatën në lidhje me dialogun me Kosovën sepse, siç vlerësoi ai, nuk është e gatshme ta pranojë realitetin se "nuk ka më diçka që quhet Kosovë dhe Metohi, por vetëm Republika e Kosovës". "Serbia është më përgjegjësja për situatën që kemi në dialog, sepse nuk është e gatshme të pranojë realitetin, dhe realiteti ka ndryshuar. Nuk ka më diçka që quhet Kosovë dhe Metohi, ekziston Republika e Kosovës", tha Rama.

I pyetur për faktin se pesë vende të Bashkimit Evropian ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, kryeministri shqiptar u përgjigj se pesë nga 27 shtete përbëjnë një numër të vogël dhe tregojnë se shumica dërrmuese e ka pranuar realitetin. "Kjo nuk ka të bëjë me dobësinë. Ka të bëjë me pranimin e faktit se realiteti ka ndryshuar. Ashtu si të gjithë popujt e tjerë të ish-Jugosllavisë gjetën rrugën e tyre dhe u bënë të pavarur, edhe shqiptarët patën të drejtën e vetëvendosjes. Sigurisht, me bashkëpunim të mirë dhe një marrëdhënie harmonike me pakicën. Sot, shqiptarët nuk janë më pakicë në Serbi, por serbët janë pakicë në Kosovë", tha Rama.

Ai theksoi se në fund të fundit Serbia është vendi më i madh në rajon dhe se ka rolin dhe historinë e vet për t'u marrë me të. "Sipas mendimit tim, dhe e thashë këtë në Beograd, sa më shpejt Serbia të përballet me realitetin se ekziston një realitet i ri, aq më mirë do të jetë", tha Rama.

# KOSOVA E SHPALL MINISTREN SERBE PERSON 'TË PADËSHIRUESHËM' PAS DEKLARATAVE TË SAJ PËR 'SPASTRIM ETNIK'

Prishtinë, 15 korrik - Kosova e ka shpallur person "të padëshirueshëm" dhe ia ka ndaluar përherë hyrjen apo kalimin nëpër vend ministres serbe Snezhana Paunoviq, pasi ajo tha ditë më parë se do ta kishte "spastruar etnikisht Kosovën" në vitin 1998, ka njoftuar ministri i Brendshëm në detyrë i Kosovës, Xhelal Sveçla.

Sveçla njoftoi në "Facebook" se e ka nënshkruar vendimin për t'ia ndaluar përgjithmonë hyrjen në Kosovë apo kalimin nëpër vend ministres serbe për Administratë Publike dhe Vetëqeverisje Lokale.

Ai tha se me deklaratat e saj, Paunoviq e ka "ritheksuar atë nga e cila Serbia nuk ka hequr dorë asnjëherë, projektin e spastrimit etnik të shqiptarëve". "Në epokën tonë, kjo u tentua nga ish-shefi i saj Sllobodan Milloshevіq, i njohur edhe si kasapi i Ballkanit", shkroi Sveçla.

Ai shtoi se "çdo përpjekje për të ringjallur ideologjitë e spastrimit etnik apo për të kërcënuar Republikën e Kosovës do të përballet me përgjigje të vendosur, ligjore dhe institucionale".

Paunoviq deklaroi të shtunën për televizionin serb "Kurir", se po të ishte në vend të Milloshevіqit në vitin 1998, "do ta kishte spastruar etnikisht Kosovën" – duke nxitur reagime dhe dënime në Kosovë dhe më gjerë.

Milloshevіqi ishte president i Republikës Federale të Jugosllavisë dhe i akuzuar nga Tribunali i Hagës për krime lufte.

"Kjo është deklarata më e ashpër që kam bërë ndonjëherë në jetën time", tha Paunoviq.

Ajo tha se "nuk do t'i kishte likuiduar shqiptarët ashtu siç ata po përpiqen ta pastrojnë etnikisht Kosovën, por në atë mënyrë që secili që ndihej më pak qytetar i Republikës Federale të Jugosllavisë, të largohej dhe të shkonte në shtetin e vet amë".

Në një reagim tjetër të martën, Paunoviq tha se nuk heq dorë nga politika e Partisë Socialiste të Serbisë - pjesë e së cilës është që nga viti 1992. "Ne jemi partia që e udhëhoqi Serbinë në rrethana jashtëzakonisht të vështira historike, partia që bëri sakrifica të mëdha - emri i së cilës është përmendur më së shumti në Hagë", shkroi ajo në rrjetet sociale.

Deklaratat e saj u dënuan si në Bashkimin Evropian, ashtu edhe në Kosovë.



Zëdhënësja e Komisionit Evropian, Anitta Hipper, tha se BE-ja nuk komenton deklarata individuale, por theksoi se në Evropë nuk ka vend për retorikë që arsyeton ose promovon spastrimin etnik. "Deklarata të tilla bien ndesh me vlerat e dinjitetit njerëzor, pajtimit, llogaridhënies dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore, mbi të cilat është ndërtuar Bashkimi Evropian", tha Hipper duke iu adresuar gazetarëve në Bruksel.

Ngjashëm reagoi edhe komisionarja për Zgjerim e BE-së, Marta Kos, e cila tha se është e tronditur nga deklarata e ministres Paunoviq.

Ajo shfaqi shpresën se bëhet fjalë për një qëndrim individual, e jo për qëndrimin e gjithë Qeverisë së Serbisë.

## Deklarata skandaloze e ministres serbe, Ahmeti: Është tronditëse, çnjerëzore dhe e papranueshme



PRISHTINË, 15 KORRIK - Lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, ka reaguar ndaj ministres serbe, e cila ka deklaruar se po të ishte në vend të Sllobodan Milloshevіqit në vitin 1998, do ta kishte spastruar etnikisht Kosovën. Ai ka bërë me dije se kjo deklaratë është tronditëse, çnjerëzore dhe e papranueshme.

Në "Facebook", Ahmeti ka shkruar se një deklaratë e tillë nuk është vetëm fyerje për viktimat e luftës, por edhe pasqyrim i një mentaliteti që frymëzohet nga politika kriminale. "Deklarata e ministres së Serbisë, e cila tha se, po të ishte në vend të Sllobodan Milloshevіqit, do ta kishte spastruar etnikisht Kosovën në vitin 1998, është tronditëse, çnjerëzore dhe e papranueshme. Një deklaratë e tillë nuk është vetëm fyerje për viktimat e luftës, por edhe pasqyrim i një mentaliteti që frymëzohet nga politika kriminale e mentorit të saj politik, Sllobodan Milloshevіqit, i cili përfundoi duke u përballur me drejtësinë ndërkombëtare për krimet e regjimit të tij. Të flasësh sot për spastrim etnik si alternativë politike, kur bota ka parë fëmijë të vrarë, masakra mbi civilë të pafajshëm, varreza masive dhe dëshmi të panumërta të krimeve të kryera në Kosovë, është dëshmi e një mendësie të rrezikshme dhe të papajtueshme me vlerat njerëzore, demokratike dhe evropiane. Mohimi ose glorifikimi i politikave gjenocidale nuk mund të ketë vend në shekullin XXI", ka thënë Ahmeti, duke shtuar se historia e ka dhënë përgjigjen e saj. "Pikërisht përballë këtij mentaliteti kriminal u ngrit rezistenca e popullit të Kosovës, e cila u kurorëzua me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Në krah të aleatëve tanë ndërkombëtarë, UÇK-ja solli lirinë dhe çlirimin e Kosovës. Ata që edhe sot ëndërrojnë spastrim etnik duhet ta dinë se ideologjitë e urrejtjes gjithmonë përfundojnë në bankën e historisë, ndërsa liria dhe e drejta triumfojnë", ka theksuar lideri i BDI-së, Ali Ahmeti.



# GLPS DHE KDI U BËJNË THIRRJE PARTIVE POLITIKE: KA ARDHUR KOHA PËR KOMPROMIS DHE FUNKSIONALIZIMIN E INSTITUCIONEVEA

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), duke marrë parasysh krizën e thellë politike dhe institucionale që ka karakterizuar vendin për pothuajse dy vjet, u kanë bërë thirrje partive politike parlamentare që të ndërmarrin, pa vonesë, hapat e nevojshëm për konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë. Sipas këtyre dy organizatave, konsensusi politik nuk duhet të perceptohet si shenjë dobësie politike, por si dëshmi e pjekurisë demokratike dhe e përgjegjësisë ndaj qytetarëve

EPOKA E RE Mal QORRAJ

**Prishtinë, 15 korrik** - Pas certifikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të 7 qershorit, ka filluar afati kushtetues për konstituimin e legjislaturës së re të Kuvendit.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) i kanë bërë thirrje spektrit politik që ta marrë përgjegjësinë kushtetuese dhe politike për tejkalimin e bllokadës institucionale, duke vendosur interesin shtetëror dhe atë të qytetarëve mbi interesat partiake.

Këto organizata të shoqërisë civile kanë theksuar se gati dy vjet qytetarët e Kosovës po përballen me pasoja direkte të një sistemi politik të paaftë për të prodhuar stabilitet institucional. "Përgjegjësia kryesore politike për tejkalimin e kësaj situate bie mbi subjektin politik që ka dalë i pari nga zgjedhjet dhe që ka marrë mandatin më të madh qytetar për të udhëhequr procesin e formimit të institucioneve. Lëvizja Vetëvendosje, si subjekt fitues i zgjedhjeve, nuk mund të kufizohet vetëm në pretendimin e legjitimitetit elektoral por ka obligim politik dhe kushtetues dhe në mënyrë proaktive të ndërmarrë hapa për tejkalimin e krizës. Në të njëjtën kohë, edhe partitë e tjera parlamentare kanë po aq detyrim kushtetues dhe përgjegjësi politike në tejkalimin e bllokadës institucionale", ka thënë GLPS në një komunikatë për medie.

Duke konsideruar krizën e thellë politike dhe institucionale që ka karakterizuar vendin tonë që pothuajse dy vjet, GLPS u bënë thirrje të gjitha partive politike parlamentare që të ndërmarrin pa vonesë hapat e nevojshëm për konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë. "Këto nuk janë çështje të negocimit të pafund politik, por obligime kushtetuese që burojnë nga vullneti i qytetarëve të shprehur në zgjedhje. Paralelisht, partitë politike duhet të ndërtojnë një dialog serioz dhe të përgjegjshëm edhe për çështjen që pritet të jetë vendimtare për stabilitetin institucional, zgjedhja e Presidentit/es. Duke pasur parasysh rëndësinë kushtetuese të këtij procesi dhe përvojat e mëhershme të krizave institucionale, është e domosdoshme që partitë politike të mos presin afate strikte kushtetuese, por të ndërtojnë ura komunikimi me qëllim të arritjes së një konsensusi në këtë drejtim. Skenarët e prolongimit dhe mos arritjes së konsensusit për zgjedhjen e Presidentit/es, do të sjellnin epilogun e njëjtë të bllokadës institucionale, edhe nëse do ketë konstituim të Kuvendit dhe formim të Qeverisë", thuhet në komunikatën e GLPS-së.

Sipas GLPS-së, pasojat e krizës nuk janë abstrakte, qytetarët po paguajnë koston. "Pasojat e bllokadës së deritanishme janë të prekshme në pothuajse çdo sektor. Procesi legjislativ është bllokuar, ndërsa shumë iniciativa të rëndësishme ligjore dhe reformuese nuk kanë avancuar. Reformat në administratë publike, drejtësi, ekonomi, energji, shëndetësi, arsim dhe fusha të tjera strategjike kanë mbetur pezull ose janë zhvilluar me ritëm shumë më të ngadaltë sesa kërkojnë nevojat e vendit. Rritja e kostos së jetesës, papunësia dhe emigrimi kërkojnë institucione që marrin vendime dhe jo institucione të bllokuara nga kalkulimet politike. Në aspektin ekonomik, mungesa e stabilitetit institucional dhe reformave strukturore ka krijuar pasiguri për investitorët, dhe ka ngadalësuar zbatimin e politikave zhvillimore, duke kufizuar aftësinë e institucioneve për t'iu përgjigjur sfidave ekonomike me të cilat përballen qytetarët", thuhet në komunikatën e kësaj organizate.

GLPS-ja ka theksuar se në politikën e jashtme, një shtet që vazhdimisht paraqitet me kriza të brendshme institucionale humb kredibilitet dhe dobëson pozitën e tij përballë partnerëve ndërkombëtarë. "Kosova nuk mund të kërkojë mbështetje më të madhe ndërkombëtare për integrim dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare, ndërkohë që nuk arrin të garantojë funksionimin bazë të institucioneve të veta. Po ashtu, në një kontekst të krizave të thella globale të sigurisë, pasiguria e brendshme politike e dobëson aftësinë e vendit për të reaguar në mënyrë strategjike dhe për të garantuar stabilitet dhe siguri afatgjatë për qytetarët. Kosova ndodhet në

→

# DORËZOHEN NËNSHKRIMET PËR KUVEND TË JASHTËZAKONSHËM TË LDK-së MES THIRRJEVE PËR SHKARKIMIN E ABDIXHIKUT

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 KORRIK - Të mërkurën janë dorëzuar 150 nënshkrimet e nevojshme për thirrjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).
Dorëzimin e këtyre nënshkrimeve e kanë bërë deputeti i zgjedhur i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend Zemaj, dhe kryetari i Degës së Dytë të LDK-së në Prishtinë, Florian Dushi. "Po, mund të konfirmoj se nënshkrimet janë dorëzuar te Sekretari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), në pajtim me dispozitat e Statutit të LDK-së", ka thënë Zemaj për "Epokën e re".
Edhe sekretari i LDK-së, Ilir Ferati, ka konfirmuar se kanë pranuar listën më nënshkrime.
Ferati ka thënë se do të krijohet një Komision për verifikimin e nënshkrimeve dhe pastaj ose vetë si sekretar ose kryetari i LDK-së do të japin hollësi për numrin e nënshkrimeve dhe hapat më tutje. "Kemi pranuar kërkesën e nënshkruesve dhe bashkangjitur një kopje e nënshkrimeve. Numrin s'mund ta themi, sepse jemi në proces të verifikimit. Do të krijojmë një komision dhe do të verifikojmë. Pasi që të bëhet procesi i verifikimi preliminar, dalim ose unë ose kryetari me një mesazh", ka thënë Ferati për "Express".
Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka reaguar në "Facebook" pas dorëzimit të nënshkrimeve të nevojshme për thirrjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ai ka thënë se forca e LDK-së është vullneti i anëtarësisë, jo ambicia e individëve. "Askush nuk është mbi LDK-në dhe anëtarësinë e saj", ka shkruar Hoti.
Kjo iniciativë është ndërmarrë me synimin për shkarkimin e Lumir Abdixhikut nga posti i kryetarit të LDK-së, pasi partia u rendit sërish e treta në zgjedhjet e 7 qershorit.
Më herët Abdixhiku kishte refuzuar kërkesat e disa degëve të partisë për të dhënë dorëheqje.
Sipas Statutit të LDK-së, Kuvendi i Jashtëzakonshëm mund të thirret me kërkesën e të paktën 1/3 së delegatëve të Kuvendit.
Kuvendin e partisë e përbëjnë 354 delegatë të zgjedhur në kuvendet e degëve, plus kryetari aktual i LDK-së, që me automatizëm është delegat i Kuvendit të Përgjithshëm të LDK-së.
Grumbullimi i nënshkrimeve të nevojshme vjen pas përplasjeve të hapura brenda LDK-së dhe pakënaqësive me Abdixhikun, pasi partia doli e treta në zgjedhjet parlamentare të qershorit, duke fituar 18 vende në Kuvendin e Kosovës me 120 deputetë.
Po ashtu, ky zhvillim po ndodh në një kohë kur Abdixhiku nisi javën e kaluar bisedimet me liderin e partisë fituese, Albin Kurtin e Lëvizjes Vetëvendosje, në përpjekje për të arritur një marrëveshje për formimin e institucioneve të reja.



## Çfarë ndodhi?

Pasi LDK-ja, e cila garoi në një listë të përbashkët me ish-presidenten Vjosa Osmani, dështoi të arrijë rezultat bindës zgjedhor më 7 qershor, filluan pakënaqësitë brenda partisë, të cilët nuk ishin diçka e re, gjithsesi.
Në fund të qershorit, së paku dy kryetarë komunash dhe disa drejtues degësh kërkuan publikisht dorëheqjen e Abdixhikut, duke argumentuar se ai duhet të marrë përgjegjësi për rezultatin zgjedhor dhe për mungesën e një rritjeje të ndjeshme elektorale.
Abdixhiku iu përgjigj kritikëve me kundërkërkesë, duke u bërë thirrje atyre që të japin dorëheqje. Kjo nuk është hera e parë që kërkohet dorëheqja e Abdixhikut, pasi ngjashëm ndodhi edhe në janar të këtij viti, pas zgjedhjeve parlamentare të dhjetorit.
Në janar ai i mbijetoi një votëbesimi që e kishte kërkuar vetë në Kuvendin e jashtëzakonshëm të partisë.
Por, disa figura partiake kishin kërkuar dorëheqjen e tij të parevokueshme, duke mos u pajtuar me votëbesim. Në mesin e tyre ishte Hykmete Bajrami, e cila ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga pozita e nënkryetares së partisë.
Para atij Kuvendi, anëtari tjetër i kësaj partie, Avdullah Hoti, e shpalli kandidaturën për kryetar të partisë, por delegatët diskutuan vetëm për performancën e Abdixhikut.
Lidhja Demokratike e Kosovës është një nga partitë më të vjetra në Kosovë, e themeluar në vitin 1989 nga Ibrahim Rugova. Ajo ka luajtur rol kyç në periudhën e rezistencës paqësore dhe në ndërtimin e institucioneve demokratike të vendit.

---

një moment vendimtar për zbatimin e Agjendës së Reformave në kuadër të Planit të Rritjes. Përmbushja e këtyre obligimeve kërkon institucione funksionale, vendimmarrje efektive dhe koordinim të plotë institucional. Kosova tashmë ka humbur miliona euro nga ky proces, në mënyrë të pakthyeshme si pasojë e mosimplementimit të masave që u kaloi afati më 30 qershor 2026", ka theksuar GLPS-ja.
Sipas GLPS-së, po aq shqetësues është edhe dëmtimi i besimit të qytetarëve në demokraci, ku në zgjedhjet e fundit parlamentare morën pjesë rreth 180 mijë qytetarë më pak krahasuar me zgjedhjet e dhjetorit të vitit të kaluar. "Një rënie e tillë e pjesëmarrjes nuk duhet parë vetëm si një fenomen statistikor, por si një sinjal serioz për dobësimin e besimit të qytetarëve në aftësinë e sistemit politik për të ofruar stabilitet, përfaqësim dhe zgjidhje konkrete. Një shtet demokratik nuk matet vetëm me organizimin e zgjedhjeve demokratike, por me aftësinë për të prodhuar institucione funksionale pas zgjedhjeve. Kosova nuk ka nevojë për një krizë tjetër, por për institucione funksionale, bashkëpunim politik dhe vizion të përbashkët për të ardhmen. Konsensusi politik nuk duhet të perceptohet si dobësi politike, por si shprehje e pjekurisë demokratike dhe e përgjegjësisë ndaj qytetarëve. Prandaj, GLPS u bën thirrje të gjitha partive politike parlamentare që të sigurojnë formimin e institucioneve dhe të ndalojnë logjikën e bllokimit, duke marrë përgjegjësinë e tyre kushtetuese dhe politike", thuhet në komunikatën e GLPS-së.

## KDI-ja: Presidentja në detyrë të caktojë sa më parë datën e seancës konstituive të Kuvendit

Ndërkaq Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) i ka bërë thirrje presidentes në detyrë Albulena Haxhiu, që, pas përfundimit të konsultimeve me subjektet politike parlamentare, të caktojë sa më parë datën e mbajtjes së seancës konstituive të Kuvendit.
KDI vlerëson se afati tridhjetëditor përbën afatin maksimal kushtetues për përfundimin e këtij procesi dhe nuk duhet të shndërrohet në periudhë pritjeje, pasigurie dhe mungesë të funksionimit të Kuvendit.
"Edhe pse afati kushtetues ende nuk ka përfunduar presidentja në detyrë, ka përgjegjësi institucionale që të shmangë çdo vonesë të panevojshme dhe të sigurojë që procesi i konstituimit të Kuvendit të fillojë në kohë dhe në përputhje me interesin publik. Veçanërisht pas një periudhe të zgjatur të funksionimit me institucione në detyrë, Kosova ka nevojë për institucione me mandat të plotë, të afta për të ushtruar përgjegjësitë tyre kushtetuese dhe për t'iu përgjigjur nevojave të qytetarëve. Përvoja e proceseve të mëparshme të konstituimit të institucioneve ka treguar se vonesat e panevojshme dhe mungesa e ushtrimit me kohë të përgjegjësive institucionale mund të krijojnë bllokada dhe të dëmtojnë funksionimin normal të shtetit. Respektimi i frymës së Kushtetutës dhe parimit të funksionimit efektiv të institucioneve kërkon që përgjegjësitë kushtetuese të ushtrohen pa vonesa të panevojshme. Institucionet nuk duhet të presin afatin e fundit për të përmbushur detyrimet e tyre, por duhet të veprojnë në kohë dhe me përgjegjësi për të shmangur çdo vakum institucional", thuhet në komunikatën e KDI-së.
KDI-ja ka kërkuar nga ushtruesja e detyrës së presidentes që pas përfundimit të konsultimeve me subjektet politike parlamentare, të caktojë sa më parë datën e seancës konstituive, në një afat që mundëson përfundimin e procesit në kohë dhe shmang afrimin e panevojshëm me kufirin kushtetues të 7 gushtit; T'u bëjë thirrje publike subjekteve politike parlamentare që të marrin pjesë në mënyrë të plotë dhe konstruktive, në mënyrë që seanca të përfundojë me konstituimin e Kuvendit, dhe jo të mbetet vetëm një veprim formal procedural pa funksionalizimin e plotë të organit më të lartë përfaqësues të qytetarëve; Ta informojë publikun, brenda 48 orëve, se deri kur do të përfundojnë konsultimet dhe kur pritet të bëhet publike data e seancës konstituive
KDI-ja ka vlerësuar se konstituimi i Kuvendit është një hap i domosdoshëm për rikthimin e funksionimit të plotë të rendit kushtetues dhe për mundësimin e formimit të institucioneve të reja. "Një Kuvend i konstituuar është parakusht për avancimin e procesit të formimit të Qeverisë së re, zgjedhjen e Presidentit/es të ri/e, si dhe për ushtrimin e funksionit legjislativ dhe mbikëqyrës të Kuvendit. Prandaj, KDI i bën thirrje presidentes në detyrë që, në ushtrimin e përgjegjësive të saj kushtetuese, të caktojë sa më parë datën e mbajtjes së seancës konstituive të Kuvendit. Veprimi në kohë nuk është vetëm çështje procedure, por është çështje e përgjegjësisë institucionale, llogaridhënies publike dhe respektimit të vullnetit të qytetarëve", thuhet në komunikatën e KDI-së.

# BE: RIINTEGRIMI I GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE SERBË TRAJTOHET NË KUADËR TË DIALOGUT



PRISHTINË, 15 KORRIK - Çështja e kthimit në punë të gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në Kosovë po shqyrtohet në kuadër të procesit më të gjerë të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, tha të mërkurën zëdhënësi i Bashkimit Evropian për Radion Evropa e Lirë (REL). "Bashkimi Evropian i ka bërë vazhdimisht thirrje Serbisë për inkurajim, ndërsa Kosovës për ta mundësuar riintegrimin e personelit të drejtësisë nga komuniteti serb, në përputhje me marrëveshjet e arritura në dialog dhe me ligjet e Kosovës", thuhet në përgjigjen me shkrim për REL-in.

Zëdhënësi shtoi se BE-ja vazhdon t'u bëjë thirrje Kosovës dhe Serbisë për t'i krijuar kushtet e nevojshme për zbatimin e këtyre detyrimeve dhe të "përmbahen nga veprime që mund ta ndërlikojnë më tej këtë proces".

Përfaqësuesit e komunitetit serb u larguan kolektivisht nga institucionet e Kosovës në fund të nëntorit 2022, duke kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për të hequr nga përdorimi targat e automjeteve të lëshuara nga Serbia dhe për t'i zëvendësuar ato me targat e Kosovës.

Përveç zyrtarëve policorë dhe punonjësve të administratës lokale, dorëheqje dhanë edhe rreth 130 gjyqtarë, prokurorë dhe punonjës administrativë të sistemit të drejtësisë në katër komunat me shumicë serbe në veri: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Çështja e dorëheqjeve të pazgjidhura u rikthye në vëmendje pasi, në mes të qershorit, ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, kërkoi nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës që "pa vonesa" t'i përmbyllin procedurat lidhur me këto dorëheqje, duke argumentuar se zvarritja e tyre ndikon në funksionimin normal të sistemit të drejtësisë.

Në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë, Këshilli Gjyqësor konfirmoi se e ka pranuar letrën më 19 qershor dhe se kjo çështje do të shqyrtohet në njërën nga mbledhjet e ardhshme, në përputhje me kompetencat kushtetuese dhe ligjore.

Këshilli Prokurorial, në anën tjetër, nuk iu përgjigj kërkesës së Radios Evropa e Lirë për koment.

Largimi kolektiv i serbëve nga institucionet e Kosovës ishte iniciuar nga Lista Serbe, me mbështetjen e autoriteteve në Beograd.

Punonjësit që dhanë dorëheqje, morën kontrata të përkohshme dhe vazhduan të paguhen nga buxheti i Serbisë.

Por, me kalimin e kohës, disa prej atyre që nuk mbështesnin Listën Serbe, mbetën pa këto paga dhe njëkohësisht humbën mundësinë për t'u rikthyer në vendet e tyre të mëparshme të punës.

Pas krizave të shumta në veri të Kosovës, që kulmuan me sulmin e armatosur ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë në vitin 2023, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, bëri thirrje për rikthimin e serbëve në Policinë e Kosovës dhe në institucionet e drejtësisë.

Edhe Lista Serbe, para zgjedhjeve lokale të vitit të kaluar, pranoi se largimi nga institucionet e Kosovës kishte qenë gabim.

Nga ana tjetër, autoritetet e Kosovës, të udhëhequra nga Albin Kurti, kanë theksuar se rikthimi i serbëve në institucionet e Kosovës nuk mund të jetë çështje politike, por duhet të trajtohet si çështje juridike dhe kushtetuese.

# PLATFORMA WOG SHËNON HAP TË RËNDËSISHËM DREJT TRANSFORMIMIT DIGJITAL TË ADMINISTRATËS PUBLIKE NË KOSOVË



PRISHTINË, 15 KORRIK - Ministri në detyrë i Digjitalizimit dhe Administratës Publike, Lulëzon Jagxhiu, ka hapur punimet për fillimin e implementimit të kësaj platforme, e cila nuk është thjesht një projekt i ri i teknologjisë së informacionit. Ajo është një investim në mënyrën se si qeveria planifikon, koordinon, zbaton dhe monitoron politikat publike.

Me këtë projekt po ndërtohet shtylla e brendshme e transformimit digjital të qeverisë, duke kaluar nga procese të fragmentuara drejt një administrate më të integruar, më të koordinuar dhe të mbështetur në të dhëna.

Platforma mbarëqeveritare (Whole-of-Government Platform - WoG) do të krijojë një hapësirë të përbashkët digjitale për institucionet, duke mundësuar planifikimin strategjik, monitorimin e Programit të Qeverisë dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, menaxhimin e rrjedhave të punës, raportimin analitik, si dhe integrimin me sistemet ekzistuese qeveritare, përfshirë ato të menaxhimit të financave publike, burimeve njerëzore, pagave, aseteve, legjislacionit dhe sisteme të tjera të përbashkëta.

Përmes standardizimit të proceseve dhe automatizimit të rrjedhave të punës, kjo platformë do të ndihmojë në zvogëlimin e barrës administrative brenda institucioneve, thjeshtimin e procedurave dhe rritjen e efikasitetit institucional.

Gjatë këtij procesi së bashku me institucionet pjesëmarrëse do të shqyrtohen dhe validohen kërkesat funksionale dhe teknike të platformës, duke siguruar që ajo t'u përgjigjet nevojave të institucioneve dhe të mbështesë një administratë publike më efikase.

## APK-ja pranë qytetarëve në 11 komuna: Më shumë informim, më shumë besim, më pak korrupsion

PRISHTINË, 15 KORRIK - Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 20-vjetorit të themelimit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) ka vazhduar "Javën e Agjencisë" me aktivitete pranë qytetarëve, duke zhvilluar fushatë informuese dhe edukuese në 11 komuna të Republikës së Kosovës.

Zyrtarët e Agjencisë realizuan takime dhe bashkëbisedime të drejtpërdrejta me qytetarët, shpërndanë materiale informuese mbi mandatin dhe kompetencat e APK-së, si dhe prezantuan mekanizmat institucionalë për parandalimin e korrupsionit dhe mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara të korrupsionit.

Aktivitetet u zhvilluan në komunat: Prishtinë, Prizren, Pejë, Klinë, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë, Graçanicë dhe Novobërdë, duke përfshirë komunitete të ndryshme në funksion të informimit dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët.

Qëllimi i kësaj nisme është forcimi i lidhjes ndërmjet institucionit dhe qytetarëve, rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e integritetit dhe transparencës në sektorin publik, si dhe inkurajimi i qytetarëve që të shfrytëzojnë mekanizmat ligjorë në dispozicion për raportimin e korrupsionit dhe mbrojtjen e interesit publik.

Përmes kësaj qasjeje, Agjencia riafirmon se parandalimi i korrupsionit nuk mbështetet vetëm në mekanizmat institucionalë, por edhe në një partneritet të qëndrueshëm me qytetarët, të bazuar në besim, informim dhe komunikim të hapur.




Aktiviteti "APK pranë qytetarëve" është pjesë e programit të "Javës së Agjencisë", e cila po organizohet nga 13 deri më 17 korrik 2026, nën moton "20 Vjet Transparencë dhe Integritet - Duke Rritur Besimin, Duke Parandaluar Korrupsionin".

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mbetet e përkushtuar që, krahas forcimit të mekanizmave institucionalë, të vazhdojë të investojë në informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, si elemente thelbësore për ndërtimin e një administrate publike transparente, me integritet dhe llogaridhënëse.

## Merr detyrën kryeprokurori i ri i shtetit, Zejnulla Gashi



**Prishtinë, 15 korrik** - Në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit u mbajt të mërkurën ceremonia e dorëzim-pranimit të detyrës së kryeprokurorit të shtetit. Ushtruesi i deritanishëm i detyrës së kryeprokurorit të shtetit, Agron Qalaj, ia dorëzoi detyrën kryeprokurorit të ri të shtetit, Zejnulla Gashi, duke i uruar suksese në ushtrimin e mandatit të tij kushtetues dhe ligjor.
Me këtë rast, kryeprokurori i ri i shtetit, Zejnulla Gashi, pas pranimit të detyrës, falënderoi kolegët për besimin e dhënë, duke theksuar se do të jetë kryeprokuror i të gjithë prokurorëve dhe se së bashku me ta, do të punojë me përkushtim për forcimin e sundimit të ligjit.

# HAXHIU DHE KURTI PRESIN SEKRETARIN E PËRGJITHSHËM TË OSBE-së, KËRKOJNË ROL MË TË MADH TË KOSOVËS NË FORUMET NDËRKOMBËTARE

Faton DËRMAKU



**Prishtinë, 15 korrik** - Ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka pritur të mërkurën në takim sekretarin e përgjithshëm të OSBE-së, ambasadorin Feridun H. Sinirlioğlu. Haxhiu ka vlerësuar kontributin e Misionit të OSBE-së në zhvillimin e institucioneve të Kosovës, duke theksuar se bashkëpunimi duhet të përshtatet me realitetin dhe sfidat me të cilat përballet vendi sot. Sipas saj, gjatë takimit është theksuar rëndësia e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të Kosovës në forumet ku diskutohen çështjet që lidhen me vendin si dhe nevoja për raportim të saktë mbi situatën e sigurisë.
Po ashtu, Haxhiu ka kërkuar vazhdimin e mbështetjes së OSBE-së për forcimin e sundimit të ligjit, mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe rritjen e qëndrueshmërisë demokratike. "Kosova mbetet e përkushtuar ndaj paqes, sigurisë dhe bashkëpunimit rajonal, si dhe ndaj vazhdimit të bashkëpunimit të ngushtë me OSBE-në", ka theksuar Haxhiu pas takimit.
Edhe kryeministri në detyrë Albin Kurti e ka pritur në takim sekretarin e përgjithshëm të OSBE-së, Feridun Sinirlioğlu. "Pas takimit në maj në kuadër të Samitit të Komunitetit Politik Evropian në Jerevan të Armenisë, sot mirëprita në Prishtinë, Sekretarin e Përgjithshëm të OSBE-së, Feridun Sinirlioğlu. E falënderova ambasadorin Sinirlioğlu për bashkëpunimin dhe kontributin e vazhdueshëm të misionit të OSBE-së në Kosovë, në forcimin e institucioneve demokratike dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe mbështetjen për sundimin e ligjit", ka thënë Kurti, duke shtuar se janë të bindur që stabiliteti i vërtetë arrihet nëpërmjet forcimit të institucioneve demokratike, duke siguruar të drejta të barabarta për të gjithë, duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.
"Përveçse përparim demokratik, Kosova ka edhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Kemi rritur Bruto Produktin Vendor në 12 miliardë euro, derisa kemi shënuar përparim të madh në forcimin e sundimit të ligjit dhe sigurinë publike. Tanimë vlerësimet ndërkombëtare e njohin Kosovën si një nga vendet më të sigurta në Evropë", ka theksuar Kurti.

# DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË I FSHMN-së BËHET ANËTAR I AESOP-it



Prishtinë, 15 korrik - Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore i Universitetit të Prishtinës - Departamenti i Gjeografisë është bërë anëtar i asociuar i Shoqatës së Shkollave Evropiane të Planifikimit (AESOP), njërit nga rrjetet më të rëndësishme akademike të Evropës për planifikim hapësinor dhe urban.
Vendimi për pranimin e Departamentit të Gjeografisë është miratuar nga Këshilli i Përfaqësuesve të AESOP-it dhe është konfirmuar zyrtarisht nga Sekretariati i Përgjithshëm i kësaj organizate. Në uebfaqen e organizatës së njohur u dëshirohet mirëseardhje në AESOP këtij departamenti dhe universiteteve e fakulteteve të tjera nga Evropa të pranuara gjatë vitit 2026.
Duke u anëtarësuar në këtë rrjet, FShMN-së, UP-së dhe Departamentit të Gjeografisë u krijohen mundësi të reja për bashkëpunim akademik dhe shkencor me universitete dhe institucione partnere nga Evropa dhe më gjerë.
Personeli akademik, hulumtuesit dhe studentët e Departamentit të Gjeografisë do të kenë mundësi të marrin pjesë në konferenca, shkolla verore, grupe tematike, rrjete akademike dhe iniciativa të ndryshme të AESOP-it.
Gjithashtu, ky anëtarësim do të lehtësojë zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore, shkëmbimin e përvojave, mobilitetin akademik dhe krijimin e partneriteteve të reja ndërkombëtare.
Procesin e anëtarësimit të Departamentit të Gjeografisë në AESOP e udhëhoqi prodekani për cilësi, shkencë dhe bashkëpunim ndërkombëtar në FShMN, prof. asoc. Ferim Gashi.
AESOP-i është organizata kryesore evropiane e universiteteve dhe institucioneve të arsimit të lartë që ofrojnë programe studimi dhe zhvillojnë veprimtari kërkimore në fushën e planifikimit hapësinor, planifikimit urban dhe zhvillimit territorial.
Një ndër prioritetet kryesore të Universitetit të Prishtinës dhe njësive të tij akademike është ndërkombëtarizimi, rrjetëzimi dhe anëtarësimi në organizata të njohura evropiane dhe globale.

## Shpronësimi në Shipitullë, Thaçi intervistohet në Prokurorinë Speciale: Ma përgatitën rivalët politikë

**Prishtinë, 15 korrik** - Kryetari i komunës së Obiliqit, ish-deputet i Lëvizjes Vetëvendosje, Halil Thaçi, të mërkurën është intervistuar nga Prokuroria Speciale. Ai është intervistuar lidhur me hetimet që po zhvillohen për shpronësimet në Shipitullë. Pas përfundimit të intervistimit, Thaçi tha para medieve se është ftuar në cilësinë e dëshmitarit. Ai tha se për çdo çështje do t'i përgjigjet prokurorit. "Kurrë asnjëherë nuk do të shantazhohem, e as nuk do të kërcënohem. Kjo është një temë e përgatitur moti prej rivalëve të mi politikë që gjoja më kanë përfshirë në rastin e shpronësimeve në fshatin Shipitullë. Jam shumë i kënaqur që prokuroria ka filluar të merret me këtë çështje dhe i bëj thirrje prokurorisë që ta hetojë deri në fund këtë çështje. Unë i kam bërë thirrje edhe nga Kuvendi që të hetohet çdo keqpërdorim i mundshëm në ato pjesë", tha ai.
Më tutje, kryetari i komunës së Obiliqit tha se do të vazhdojë t'i vë në pah problemet e qytetarëve dhe, sipas tij, banorët e fshatit Shipitull dhe Hadë janë të diskriminuar dhe anashkaluar. "Gjendja e tyre për jetë është e pamundur atje...", tha ai.
I pyetur se në çfarë cilësie është ftuar në prokurori, ai tha "si dëshmitar ata natyrisht që më pyetën për çdo gjë. Dhe për çfarëdo që di do t'i përgjigjem prokurorisë".



## OEK: Deficiti tregtar i Kosovës me ShBA-në u rrit për 21.9 për qind gjatë vitit 2025

PRISHTINË, 15 KORRIK - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), duke iu referuar të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), ka bërë me dije se tregtia e mallrave ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës gjatë vitit 2025 është karakterizuar nga rritja e deficitit tregtar me 21.9 për qind krahasuar me vitin 2024. Sipas të dhënave të publikuara, eksporti i Kosovës drejt ShBA-së gjatë vitit 2025 ka arritur në 24.4 milionë euro, ndërsa importi nga ShBA-ja ka qenë 106.3 milionë euro. Si rezultat, deficiti tregtar ka arritur në 81.8 milionë euro, ndërsa mbulueshmëria e importit nga eksporti ka qenë 23.0 për qind.
OEK-u thekson se rënia e eksporteve dhe niveli i lartë i importeve tregojnë nevojën për politika që mbështesin rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve vendore dhe zgjerimin e pranisë së tyre në tregun amerikan. Të dhënat janë bazuar në statistikat zyrtare të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).



# ‘TRAINKOS’-i VË NË FUNKSION PESË VAGONË TË RINJ




PRISHTINË, 15 KORRIK - Hekurudhat e Kosovës – “Trainkos Sh. A”. kanë njoftuar se Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) ka licencuar pesë vagonë të cilët kanë përfunduar me sukses riparimin e mesëm. Sipas “Trainkos”-it ky përbën një hap të rëndësishëm në rritjen e sigurisë, besueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve hekurudhore, duke dëshmuar përkushtimin për mirëmbajtjen dhe modernizimin e flotës.
Në njoftim thuhet se vagonët e rinj do t’i bëjnë udhëtimet më të mira, më të shpejta dhe më komode për qytetarët, ndërsa është bërë thirrje që ata të ruhen dhe të mirëmbahen. “Këta vagonë janë pasuri e përbashkët e të gjithë neve. Le t’i mirëmbajmë dhe t’i ruajmë, pasi komoditeti dhe pastërtia tregojnë kulturën tonë qytetare. Ruajtja e tyre është detyrë dhe përgjegjësi e secilit prej nesh”, thuhet në postimin e “Trainkos”-it.
Po ashtu, kompania u ka bërë thirrje qytetarëve të raportojnë çdo rast të dëmtimit të qëllimshëm (vandalizmit) te stafi i trenit ose tek autoritetet kompetente.
“Trainkos”-i ka falënderuar qytetarët për besimin dhe u ka uruar udhëtime të këndshme me trenat e saj.

# PRODHIMI DHE EKSPORTI I TREPÇËS RRITEN ME 25.5 PËR QIND

PRISHTINË, 15 KORRIK - Kombinati “Trepça” ka shënuar rezultatet më të mira ndonjëherë në prodhimin dhe eksportin e koncentrateve të plumbit (Pb) dhe zinkut (Zn), gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026. Sipas të dhënave të publikuara nga ndërmarrja, Njësitë Biznesore Stantërg dhe Kishnicë kanë realizuar gjithsej 4,961.52 tonë prodhim dhe eksport të koncentrateve, duke vendosur një rekord të ri në historinë e tyre.
Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, prodhimi dhe eksporti janë rritur për 25.5 për qind, ndërsa në raport me vitin 2024 rritja arrin në 74.3 për qind.
Të dhënat tregojnë se në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 janë prodhuar dhe eksportuar 2,846.32 tonë, në vitin 2025 kjo shifër është rritur në 3,953.19 tonë, ndërsa në vitin 2026 ka arritur në 4,961.52 tonë, niveli më i lartë i regjistruar deri më tani.
Nga “Trepça” e kanë vlerësuar këtë rezultat si një sukses i rëndësishëm për sektorin minerar, duke theksuar se ky rekord dëshmon për rritjen e vazhdueshme të prodhimit dhe performancës së ndërmarrjes.



# ATK-ja APELON BIZNESET PËR REGJISTRIMIN ME KOHË TË PUNËTORËVE DHE PËRDITËSIMIN E TË DHËNAVE




PRISHTINË, 15 KORRIK - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) u ka bërë thirrje të gjitha bizneseve që t’i regjistrojnë me kohë punëtorët e rinj dhe të sigurohen që të dhënat e punëtorëve ekzistues të jenë gjithmonë të përditësuara. Përmes një postimi publik, ATK thekson se regjistrimi i punëtorëve nuk është vetëm obligim ligjor, por edhe një hap i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Sipas ATK-së, të dhënat e sakta dhe të përditësuara ndihmojnë në shmangien e parregullsive dhe në përmbushjen e obligimeve ligjore nga ana e punëdhënësve.
ATK u bënë apel bizneseve t’i respektojnë afatet për regjistrimin e punëtorëve dhe të kujdesen për përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave, duke kontribuar kështu në formalizimin e marrëdhënieve të punës dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.

## Kujdesi në trafik: Policia apelon për vigjilencë pranë makinerive bujqësore dhe mjeteve të rënda

PRISHTINË, 15 KORRIK - Policia e Kosovës u ka bërë thirrje të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion që të tregojnë kujdes të shtuar gjatë qarkullimit në rrugët ku lëvizin makineritë bujqësore, makineritë e punës dhe mjetet e tjera të rënda.
Sipas policisë, çdo vit regjistrohen mbi 100 aksidente trafiku ku përfshihen makineri bujqësore dhe mjete të ndryshme të punës, duke paraqitur rrezik serioz për drejtuesit e automjeteve dhe pjesëmarrësit e tjerë në trafik.
Autoritetet u bëjnë apel drejtuesve të automjeteve ta rrisin vigjilencën, veçanërisht në zonat rurale, t’i respektojnë rregullat e komunikacionit dhe ta ulin shpejtësinë kur afrohen pranë mjeteve të rënda.



# "ARS NOTORIA" – LIBRI I LASHTË MAGJIK QË PREMTONTE KUJTESË TË PËRSOSUR DHE URTËSI TË LARTË



Në çdo epokë të historisë, njeriu ka kërkuar mënyra për të kapërcyer kufijtë e mendjes së tij. Përpara se shkenca të fillonte të shpjegonte funksionimin e kujtesës dhe të trurit, shumë besonin se inteligjenca, urtësia dhe aftësia për të mësuar nuk ishin vetëm dhunti natyrore, por edhe bekime që mund të fitoheshin përmes ritualeve të veçanta, lutjeve dhe njohurive të fshehta. Pikërisht nga kjo dëshirë e përhershme për dije lindi një nga dorëshkrimet më misterioze të Mesjetës, Ars Notoria, një tekst që për shekuj me radhë u konsiderua si çelësi drejt një kujtese të jashtëzakonshme dhe një mendjeje të ndriçuar.

Ndryshe nga shumica e librave okultë që premtonin pasuri, pushtet apo kontroll mbi forcat e mbinatyrshme, Ars Notoria pretendonte se mund t'i ndihmonte praktikuesit të zhvillonin aftësitë e tyre intelektuale. Për studentët, murgjit, filozofët dhe dijetarët mesjetarë, ky ishte një premtim i jashtëzakonshëm. Në një kohë kur librat ishin të rrallë, universitetet sapo kishin filluar të lulëzonin dhe arsimi ishte privilegj i një pakice, ideja se ekzistonte një tekst i aftë të përmirësonte kujtesën dhe të lehtësonte përvetësimin e dijes dukej pothuajse si një mrekulli.

## Çfarë është "Ars Notoria" dhe pse konsiderohet unik?

Ars Notoria është pjesa më e vjetër e koleksionit të njohur si "Çelësat më të Vegjël të Solomonit" (Lemegeton Clavicula Salomonis), një përmbledhje e famshme grimoresh, ose librash të njohurive okulte, që u përhapën gjerësisht në Evropë gjatë shekujve XVI dhe XVII. Koleksioni përfshin pesë tekste të ndryshme: Ars Goetia, Ars Theurgia-Goetia, Ars Paulina, Ars Almadel dhe Ars Notoria. Ndërsa katër librat e parë fokusohen kryesisht në demonologji, thirrjen e shpirtrave dhe rituale të ndryshme magjike, Ars Notoria dallohet qartë nga të gjithë të tjerët. Ai nuk flet për demonë, mallkime apo talismanë, por për lutje, meditim, soditje dhe disiplinë mendore.

Dorëshkrimet më të hershme të njohura të Ars Notoria datojnë në shekullin XIII, megjithëse studiuesit besojnë se një pjesë e mirë e lutjeve dhe formulave që përmban janë shumë më të vjetra. Teksti është një përzierje e pazakontë latinishtje, greqishteje dhe hebraishtjeje, gjuhë që në Mesjetë konsideroheshin mbartëse të dijes së shenjtë. Për lexuesit e asaj kohe, kjo shumëllojshmëri gjuhësh nuk ishte thjesht një zgjedhje stilistike, por një dëshmi se libri kishte origjinë të lashtë dhe përmbante njohuri që vinin nga tradita biblike dhe filozofia antike.

## Lidhja me mbretin Solomon dhe tradita ezoterike

Vetë emri i mbretit Solomon i jepte dorëshkrimit një autoritet të jashtëzakonshëm. Në traditën hebraike, të krishterë dhe islame, Solomoni konsiderohej simboli i urtësisë absolute. Me kalimin e shekujve, figura e tij u mbështoll nga legjenda që pretendonin se ai kishte marrë njohuri të fshehta nga engjëjt dhe kishte zotëruar sekrete që nuk u ishin zbuluar njerëzve të zakonshëm. Pikërisht për këtë arsye shumë dorëshkrime okulte iu atribuuan atij, edhe pse historianët janë pothuajse të njëzëshëm se ato janë shkruar shumë shekuj pas jetës së mbretit biblik. Megjithatë, lidhja me Solomonin mjaftoi që Ars Notoria të fitonte prestigj dhe të kopjohej në manastire e biblioteka për qindra vjet.

Premtimi më i madh i librit ishte zhvillimi i një "kujtese të përsosur". Praktikuesit nuk pritej ta arrinin këtë përmes një formule magjike të vetme, por nëpërmjet një disipline të përditshme. Dorëshkrimi përshkruan një seri lutjesh që duhej të recitoheshin në orare të caktuara, të shoqëruara me soditjen e figurave simbolike, meditimin dhe përqendrimin mendor. Besohej se, me kalimin e kohës, këto ushtrime do t'i jepnin praktikuesit aftësi të jashtëzakonshme për të mësuar, për të mbajtur mend dhe për të kuptuar lëndët më të ndërlikuara, nga filozofia dhe teologjia deri te aritmetika, gjeometria dhe astronomia.

Për lexuesin modern, këto premtime mund të tingëllojnë si fantazi. Megjithatë, është interesante të vërehet se shumë nga praktikat e përshkruara në Ars Notoria ngjajnë me teknika që sot njihen në psikologjinë njohëse. Përsëritja sistematike, përqendrimi i vazhdueshëm, meditimi dhe vizualizimi janë metoda që, sipas studimeve bashkëkohore, mund të ndikojnë pozitivisht në kujtesë dhe në aftësinë për të përvetësuar informacion. Kjo nuk do të thotë se libri kishte fuqi magjike, por ndoshta një pjesë e reputacionit të tij lindi sepse praktikuesit, duke ndjekur me përpikëri një regjim të rreptë mendor, arrinin realisht të përmirësonin përqendrimin dhe disiplinën e tyre intelektuale.

Një nga pjesët më kurioze të dorëshkrimit është përshkrimi i asaj që sot njihet si "eksperimenti magnetik". Në një ilustrim shfaqen dy gjilpëra busulle që magnetizohen me të njëjtin magnet dhe vendosen në qendër të dy rrathëve me shkronja. Sipas autorit, lëvizja e njërës gjilpërë do të pasqyrohej nga tjetra, duke u mundësuar dy njerëzve të komunikonin në distanca të largëta vetëm duke orientuar gjilpërat drejt shkronjave të alfabetit. Sot dihet se një mekanizëm i tillë nuk mund të funksionojë sipas ligjeve të fizikës, por ideja është një dëshmi interesante e mënyrës se si imagjinata mesjetare përpiqej të shpjegonte forcat e padukshme të natyrës shumë kohë përpara zbulimit të elektromagnetizmit dhe telekomunikacionit modern.

## Midis magjisë, fesë dhe disiplinës mendore

Megjithëse Ars Notoria klasifikohet zakonisht si një grimor, ai zë një vend të veçantë në historinë e letërsisë ezoterike. Ndryshe nga tekstet që kërkonin thirrjen e demonëve apo lidhje me forca të errëta, ai mbështetet pothuajse tërësisht në lutje drejtuar Zotit dhe engjëjve. Pikërisht kjo natyrë e dyfishtë bëri që libri të shkaktonte debate të gjata mes teologëve. Disa e konsideronin një mjet të ligjshëm për t'iu afruar urtësisë hyjnore, ndërsa të tjerë e shihnin si një përzierje të rrezikshme mes fesë dhe magjisë, duke argumentuar se çdo përpjekje për të fituar njohuri të mbinatyrshme përmes formulave rituale binte ndesh me doktrinën e krishterë.

## Pse "Ars Notoria" vazhdon të tërheqë studiuesit edhe sot?

Edhe pas Rilindjes, kur mendimi racional filloi të fitonte terren, Ars Notoria nuk u zhduk. Përkundrazi, ai vazhdoi të kopjohej, të përkthehej dhe të studiohej nga alkimistë, mistikë dhe koleksionistë dorëshkrimesh. Në shekujt XIX dhe XX ai u bë objekt studimi për historianët e religjionit, antropologët dhe studiuesit e ezoterizmit, të cilët nuk u interesuan më për fuqitë e pretenduara të librit, por për atë që ai zbulonte mbi mënyrën se si shoqëritë mesjetare e konceptonin dijen, kujtesën dhe inteligjencën.

Sot nuk ekziston asnjë provë që Ars Notoria mund t'i japë kujtdo një kujtesë të përsosur apo aftësi mbinjerëzore. Megjithatë, rëndësia e tij historike mbetet e padiskutueshme. Ai është një dëshmi e rrallë e një epoke kur kufiri mes fesë, filozofisë, psikologjisë dhe magjisë ishte shumë më i paqartë sesa e imagjinojmë sot. Mbi të gjitha, ai pasqyron një dëshirë universale që nuk ka ndryshuar kurrë: etjen e njeriut për të mësuar më shumë, për të kuptuar më thellë botën dhe për të zgjeruar kufijtë e mendjes së vet.

Ndoshta kjo është arsyeja pse Ars Notoria vazhdon të zgjojë kureshtje edhe në shekullin XXI. Jo sepse premton mrekulli, por sepse na kujton se kërkimi për dije ka qenë gjithmonë një nga forcat më të mëdha që ka shtyrë përpara qytetërimin njerëzor. Edhe kur rrugët e zgjedhura kanë kaluar përmes mistikës dhe legjendës, synimi ka qenë i njëjtë: të bëhemi më të ditur se dje. / bota.al





# Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

## FC Drita eliminohet nga Liga e Kampionëve



**Prishtinë, 15 korrik** - Kampionia e Kosovës, FC Drita, e ka përfunduar rrugëtimin në UEFA Champions League në raundin e parë kualifikues, pasi u mposht nga kampionia e Lituanisë, Kauno Zalgiris, me rezultat 3:2, në ndeshjen e kthimit të zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri".
Pas barazimit 1:1 në takimin e parë, sfida e kthimit ishte tejet e luftuar dhe me kthesa në rezultat, ku fituesi u vendos vetëm në minutat e fundit, kur mysafirët realizuan golin e fitores nga pika e bardhë.
Mysafirët kaluan të parët në epërsi me golin e Vykintas Slivka në minutën e 9. Drita barazoi përmes Igball Jasharit, në minutën e 21-të, teksa në minutën e 53-të kaloi në epërsi me golin e Arb Manajt.
Por mysafirët nuk u dorëzuan dhe në minutat e fundit përmbysën rezultatin me golat e Vykintas Slivka (82') dhe Amine Benchaib (94') nga penalltia.

# SPANJA SIGURON FINALEN, BËHET FINALISTJA E PARË E KUPËS SË BOTËS



**Prishtinë, 15 korrik** - Spanja ka dhënë një paraqitje të madhe në gjysmëfinale dhe ka mposhtur Francën me rezultat 2-0, duke siguruar një vend në finalen e Kupës së Botës 2026.
"La Roja" kontrolloi ndeshjen me pjekuri, duke qenë më e rrezikshme dhe më efikase në çastet vendimtare, ndërsa Franca nuk arriti ta gjente mënyrën për ta thyer mbrojtjen spanjolle.
Spanja kaloi në epërsi në minutën e 22-të. Pas një ndërhyrjeje të Lucas Dignes ndaj Lamine Yamalit brenda zonës, gjyqtari akordoi penallti. Nga pika e bardhë u tregua i saktë Mikel Oyarzabal, i cili mposhti portierin Mike Maignan dhe i dha avantazhin skuadrës së Luis de la Fuente.
Franca tentoi të reagojë, por Spanja ishte shumë e organizuar. "Gjelat" krijuan disa raste, por nuk arritën të finalizonin aksionet e tyre.
Në pjesën e dytë, Spanja e goditi sërish. Në minutën e 58 Dani Olmo me një pasim të bukur gjeti Pedro Porron brenda zonës, ndërsa mbrojtësi spanjoll realizoi me goditje të parë për rezultatin 2-0.
Franca u përpoq të rikthehej në lojë, me Kylian Mbappen dhe futbollistët ofensivë që kërkuan golin e shpresës, por mbrojtja spanjolle qëndroi e palëkundur.
Me këtë fitore Spanja kalon në finalen e Kupës së Botës 2026, ndërsa Franca eliminohet pas një rrugëtimi të fortë në turne, ndërsa do të luajë për vendin e tretë.
"La Roja" tashmë pret kundërshtarin e finales mes Argjentinës dhe Anglisë dhe është vetëm një hap larg lavdisë së madhe botërore.

# PSG E SAKRIFIKON FABIAN RUIZ PËR TË NËNSHKRUAR ME YLLIN E BARCELONËS

**Prishtinë, 15 korrik** - Paris Saint-Germain mund të bëjë një lëvizje të madhe në mesfushë gjatë këtij afati kalimtar, pasi e ardhmja e Fabian Ruiz ka hyrë në pikëpyetje.
Skuadra e Luis Enriques vjen pas një prej sezoneve më të suksesshme në historinë e klubit, duke fituar pesë trofe, mes tyre titullin e Ligën 1 dhe Ligën e Kampionëve për të dytin vit radhazi. Megjithatë, kampionët e Francës kanë nisur tashmë ndryshimet në skuadër.
Lucas Digne është transferuar nga Aston Villa. Nga ana tjetër, Gonçalo Ramos është larguar drejt Milanit, duke detyruar PSG-në të kërkojë alternativa të reja në sulm. Klubi francez ka zhvilluar bisedime për Ferran Torres dhe vazhdon ta monitorojë Julian Alvarez.
Megjithatë, ndryshime mund të ketë edhe në mesfushë. Fabian Ruiz zhvilloi një sezon të shkëlqyer me PSG-në dhe ka vazhduar me paraqitje të mira edhe me Spanjën në Kupën e Botës, duke tërhequr interesimin e disa klubeve të mëdha evropiane.
Sipas "El Nacional", Luis Enrique është i gatshëm ta lejojë largimin e Fabian Ruiz nëse PSG arrin të afrohet më shumë me objektivin e madh të merkatos, mesfushorin e Barcelonës, Gavi.



# ESTUPINAN NË LIGËN PREMIERE DHE MË SHUMË: MILANI SYNON TË PËRFITOJË MBI 150 MILIONË EURO NGA SHITJET



**Prishtinë, 15 korrik** - Milani po përgatitet për një verë me shumë largime, pasi drejtuesit e klubit synojnë të arkëtojnë rreth 150 milionë euro nga shitja e lojtarëve për ta përmirësuar gjendjen financiare dhe për t'i financuar afrimet e reja.
Pasi siguroi transferimet e Gonçalo Ramos dhe Mario Gilas për një shumë totale prej rreth 50 milionë eurosh, klubi kuqezi tani është përqendruar te largimet.
Sipas "Gazzetta dello Sport", Pervis Estupinan është një nga lojtarët më pranë largimit. Mbrojtësi i majtë po zhvillon bisedime të avancuara me Aston Villan, ndërsa mediet italiane raportojnë se Milani kërkon rreth 20 milionë euro për kartonin e tij. Megjithatë, klubi mund të pranojë edhe një ofertë prej 15 milionë eurosh.
E njëjta shumë pritet të kërkohet edhe për Fikayo Tomorin, i cili gjithashtu mund të largohet gjatë kësaj vere.
Ndërkohë, trajneri Ruben Amorim nuk llogarit në disa mesfushorë. Milani është i gatshëm të dëgjojë oferta për Youssouf Fofanan, Ruben Loftus-Cheek dhe Warren Bondon.
Një tjetër emër i madh në listën e transferimeve është Rafael Leao. Sulmuesi portugez është në treg për rreth 60 milionë euro, por deri më tani nuk ka mbërritur asnjë ofertë zyrtare, veçanërisht nga klubet e pesë ligave më të forta të Evropës. Sipas raportit, objektivi i Milanit është të arkëtojë rreth 150 milionë euro nga shitjet gjatë këtij afati kalimtar si pasojë e mungesës në Ligën e Kampionëve, por edhe për të krijuar një buxhet më të madh për përforcimin e skuadrës.

## UEFA delegon ekipin e gjyqtarëve nga Kosova për ndeshjen Virtus - Dila në Conference League

**Prishtinë, 15 korrik** - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka njoftuar se një tjetër ekip i gjyqtarëve kosovarë është deleguar nga UEFA për ta ndarë drejtësinë në garat evropiane.
Sipas njoftimit të FFK-së, gjyqtari ndërkombëtar Mervan Bejtullahu do ta drejtojë ndeshjen e UEFA Conference League ndërmjet Virtus dhe Dila, e cila do të zhvillohet më 16 korrik në San Marino.
Bejtullahu do të ndihmohet nga asistentët Edmond Zeqiri dhe Fatmir Sekiraqa, ndërsa gjyqtar i katërt është caktuar Lirim Jashari.
FFK e ka cilësuar këtë delegim si një tjetër vlerësim i rëndësishëm nga UEFA dhe dëshmi të besimit të vazhdueshëm në profesionalizmin dhe cilësinë e gjyqtarëve kosovarë.
Federata u ka uruar sukses gjyqtarëve në këtë sfidë evropiane, duke shprehur besimin se ata do ta përfaqësojnë denjësisht futbollin e Kosovës në arenën ndërkombëtare.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit Kombëtare (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 05/2026), lidhur me nenin 42 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2025), Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2026 si dhe Vendimit të Auditores së Përgjithshme me Nr.1237 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

**KONKURS**
**për plotësimin e vendit të lirë të punës**

1. **Pozita:** **Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa**
   **Numri i referencës:** ZLBF/ZKA/08-07/26
   **Grada:** ZKA- X6
   **Numri i pozitave:** Një (1)
   **Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të pacaktuar

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Pranon dhe kontrollon të gjitha kërkesat e arritura për pagesë, sigurohet së janë në harmoni me Ligjin dhe rregulloret në fuqi;
- Siguron disponueshmërinë dhe alokimin e buxhetit në përputhje me procesin e fillimit të çdo aktiviteti dhe buxhetin e planifikuar;
- Mbikëqyr dhe vepron përmes sistemit informativ dhe procedurat për monitorimin e secilit proces të shpenzimeve buxhetore nga zotimi i mjeteve deri te ekzekutimi në Departamentin e Thesarit në MF;
- Bënë analizimin dhe kontrollimin e shpenzimeve si dhe regjistrimin e pagesave sipas kodeve dhe shumes në Sistemin Informativ të Financave të Kosovës (SIMFK)- Free Balance;
- Përmes raporteve të MFPT (SIMFK) përcjellë realizimin e pagesave dhe bënë barazimin e shpenzimeve në nivel ZKA-së;
- Përgatit dhe i raporton për planin dinamike të shpenzimeve për çdo javë, muaj, periudhe tremujorë e vjetor edhe mbanë kontakte të përhershme me zyrtarët përgjegjës për shpenzime të departamenteve përkatëse;
- Mban kontakte për punët dhe aktivitetet financiare dhe shpenzime me certifikuesin dhe zyrtarin kompetent të financave si dhe me udhëheqësit e programeve buxhetore;
- Menaxhon bazën e të dhëna për shpenzimet, kryen barazimet buxhetore dhe përgatitë raporte periodike dhe vjetore për shpenzime sipas kategorive dhe nën kategorive ekonomike dhe programeve ndaras për vitin aktual dhe raporton për gjendjen;
- Monitoron shpenzimet e buxhetit gjatë gjithë vitit brenda ZKA-së dhe rekomandon rialokimin e buxhetit kur është e nevojshme si dhe përgatitë raporte mbi shpenzimet buxhetore
- Kryen edhe detyra tjera profesionale në pajtim me legjislacionin, të cilat mund të kërkohen nga mbikëqyrësi.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi;
- Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në administratë, buxhet dhe financa.

**Informata të përgjithshme për kandidatë:**
Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Procedura e Aplikimit:**
Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

**Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:**

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **31.07.2026 ora 16.00.**

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

**Shënim:**
Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Na osnovu člana 15.2 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i članova 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 01/2024 o prijemu i karijeri u Nacionalnoj kancelariji revizije (izmenjenog i dopunjenog Pravilnikom (NKR) br. 05/2026), u vezi sa članom 42 Pravilnika (NKR) 03/2024 o klasifikaciji radnih mesta (izmenjenog i dopunjenog Pravilnikom (NKR) br. 03/2025), Godišnjeg plana zapošljavanja za 2026. godinu, kao i Odluke Generalne revizorke br. 1237 o popunjavanju slobodnog radnog mesta, Nacionalna kancelarija revizije objavljuje:

**KONKURS**
**Za ispunjavanje slobodnog radnog mesta**

1. **Pozicija:** **Viši Službenik za Budžet i Finansije**
   **Referentni broj :** ZLBF/ZKA/08-07/26
   **Rang:** NKR-X6
   **Broj pozicija:** Jedna (1)
   **Trajanje imenovanja:** Na neodređeno vreme

**Dužnosti i odgovornosti:**

• Prima i kontroliše sve primljene zahteve za plaćanje, obezbeđuje da su u skladu sa Zakonom i važećim propisima ;
• Osigurava dostupnost i raspodelu budžeta u skladu sa procesom pokretanja svake aktivnosti i planiranim budžetom;
• Nadzire i posluje kroz informacioni sistem i procedure za praćenje svakog procesa budžetskih rashoda od angažovanja sredstava do izvršenja u Odeljenju Trezora Ministarstva Finansija
• Analizira i kontroliše troškove kao i evidentiranje isplata prema šiframa i iznosima u Informacionom Sistemu Finansija Kosova (ISFK) – Free Balance;
• Kroz izveštaje MFPT (ISFK), pratiti realizaciju isplata i usaglašavanje troškova na nivou NKR;
• Priprema i izveštava o dinamičkom planu troškova za svaku sedmicu, mesec, tromesečje i godišnji period i održava stalne kontakte sa službenicima odgovornim za troškove nadležnih odeljenja;
• Održava kontakte za finansijske poslove i troškove sa overiocem i nadležnim finansijskim službenikom kao i sa rukovodiocima budžetskih programa;
• Upravlja bazom podataka za troškove, vrši usaglašavanje budžeta i priprema periodične i godišnje izveštaje za troškove po kategorijama i po ekonomskim kategorijama i posebne programe za tekuću godinu i izveštaje o stanju;
• Prati budžetske rashode tokom cele godine u okviru NKR-a i preporučuje preraspodelu budžeta kada je to potrebno, kao i priprema izveštaje o budžetskim rashodima
• Obavlja i druge stručne poslove u skladu sa zakonskom regulativom, koje može zahtevati nadzornik.

Opšti formalni zahtevi za ovu radnu poziciju, su:

- Obrazovanje: Fakultetska diploma ekonomskog smera;
- Profesionalno iskustvo: Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u administraciji, budžetu i finansijama;

**Opšte informacije za kandidate:**
Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonodavstvom.

**Postupak prijavljivanja:**

Postupak prijavljivanja je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja prijave kandidata iz svih zajednica na Kosovu.

**Kandidati moraju dostaviti potrebnu dokumentaciju, i to:**
• službeni obrazac NKR-a za prijavu;
• kopiju lične karte Republike Kosovo;
• dokaz o školskoj spremi (Fakultetska diploma). Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
• dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o Radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
• potvrdu iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne stariju od šest meseci);
• dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (*ako se primenjuje*);

U obzir će se uzeti samo zvanični obrazac za prijavu. Dokumenti dostavljeni nakon roka neće se razmatrati, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (*online*) i na internetskoj stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za predaju dokumentacije je dana **31.07.2026 u 16.00h.**

Obrasci za prijavu mogu se dobiti na recepciji NKR-a, ili se mogu preuzeti sa web stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org predati Odeljenju za administraciju dokumenata na adresi: Naselje Arberia , ul . "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00 časova, obrazac i prateća dokumentacija se mogu dostaviti i putem imejla na adresu rekrutimi@oagks.org ili putem pošte. Za detaljnije informacije možete nas kontaktirati na tel. 038/606-004, lokal 1025.

**Napomena:**

Prijave poslate poštom, koje nose poštanski pečat pošiljke poslate poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmatrane.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit Kombëtare (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 05/2026), lidhur me nenin 46 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2025), Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2026 si dhe Vendimit të Auditores së Përgjithshme me Nr.1237 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

**KONKURS**
**për plotësimin e vendit të lirë të punës**

1. **Pozita:** **Përkthyes (Shqip – Anglisht dhe anasjelltas)**
**Numri i referencës:** PSA/ZKA/09-07/26
**Grada:** ZKA-X6
**Numri i pozitave:** Një (1)
**Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të pacaktuar

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**
- Ndihmon Udhëheqësin e divizionit në përcaktimin e objektivave dhe hartimin e planeve të punës;
- Bën përkthimin e dokumenteve nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas sipas normativit të përcaktuar për një ditë pune. Normativi mesatar për përkthim të dokumenteve brenda një ditë pune përfshinë mesatarisht 2000 fjalë.
- Bënë përkthimin simultan në takime pune, punëtori, konferenca, trajnime dhe në raste të tjera sipas nevojave të ZKA-së;
- Ndihmon në përcaktimin dhe harmonizimin e terminologjisë, për shkresat dhe dokumentet e përkthyera si dhe saktësinë e tyre me kuptim të qartë dhe sipas normave gramatikore dhe të sintaksës;
- Mban bazën e të dhënave dhe informacioneve lidhur me përkthimet e bëra të të gjitha dokumenteve.

**Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës janë:**
- Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkencat shoqërore;
- Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale;
- Preferohet çertifikatë/licencën në përkthim të gjuhës angleze.

**Shkathtësitë e kërkuara**:
- Njohuri dhe përvojë në fushën e përkthimeve;
- Njohuri në terminologjinë e fushës së auditimit, kontabilitetit dhe financave;
- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

**Informata të përgjithshme për kandidatë:**
Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Procedura e Aplikimit:**
Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

**Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:**
- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **31.07.2026 ora 16.00.**

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

**Shënim:**
Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Shodno članu 15.2 Zakona br. 05/L-055 o generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i članovima 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 01/2024 o prijemu i karijeri u Nacionalnoj kancelariji revizije (izmenjen i dopunjen Pravilnik (NKR) br. 05/2026), u vezi sa članom 46 Pravilnik (NKR) 03/2024 o klasifikaciji radnih mesta ( izmenjen i dopunjen Pravilnikom (NKR) br. 03/2025), Godišnjim planom zapošljavanja za 2026. godinu i Odlukom generalne revizorke br. 1237 o popunjavanju upražnjenog radnog mesta, Nacionalna kancelarija revizije objavljuje:

**KONKURS**
**za popunjavanje upražnjenog radnog mesta**

1. **Pozicija:** **Prevodilac (albanski – engleski i obrnuto)**
**Referentni broj:** PSA/ZKA/09-07/26
**Rang:** ZKA-X6
**Broj pozicija:** Jedna (1)
**Trajanje imenovanja:** Na neodređeno vreme

**Dužnosti i odgovornosti:**
- Pomaže rukovodiocu odseka u određivanju ciljeva i izradi planova rada;
- Prevodi dokumenta sa albanskog na engleski jezik i obrnuto prema standardu utvrđenom za jedan radni dan. Prosečan normativ za prevođenje dokumenata unutra jednog radnog dana obuhvata prosečno 2000 reči.
- Vrši simultano prevođenje na sastancima, radionicama, konferencijama, obukama i drugim prilikama prema potrebama NKR-a;
- Pomaže u utvrđivanju i usklađivanju terminologije za prevedene dokumente i prepiske, kao i njihovoj tačnosti sa jasnim značenjem i u skladu sa gramatičkim i sintaksičkim normama;
- Vodi bazu podataka i informacije u vezi izvršenih prevoda svih dokumenata.

**Opšti formalni zahtevi za ovu radnu poziciju su:**
- Obrazovanje: Diploma fakulteta društvenih nauka;
- Profesionalno iskustvo: tri (3) godine stručnog radnog iskustva;
- Poželjno je imati sertifikat/licencu za prevod engleskog jezika.

**Potrebne veštine** :
- Znanje i iskustvo u oblasti prevoda;
- Poznavanje terminologije iz oblasti revizije, računovodstva i finansija;
- Veštine komunikacije i planiranja rada;
- Sposobnost završetka zadataka i rada pod pritiskom;
- Računarske veštine u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, internet).

**Opšte informacije za kandidate:**
Utvrđivanje plate se vrši u skladu sa važećim zakonodavstvom.

**Postupak prijave:**
Postupak prijave je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna kancelarija revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i sa zadovoljstvom dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

**Kandidati treba da dostave potrebnu dokumentaciju, kao sledeće:**
- zvanični obrazac za prijavu NKR-a;
- kopija lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o obrazovnoj spremi (diploma fakulteta). Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- dokaz iz suda da nije pravosnažno osuđen (ne stariji od šest meseci);
- dokaz da nema na snazi disciplinska mera za uklanjanje sa javne funkcije ( *ako je primenljivo*);

Samo zvanični obrazac za prijavu će biti uzet u obzir. Dokumenti dostavljeni nakon roka neće biti razmatrani, dokle oni nekompletirani će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (*onlajn*) i na veb stranici Nacionalne kancelarije revizije. Poslednji rok za dostavu dokumentacije je **31.07.2026.godine u 16:00 časova.**

Obrasci za prijavu mogu se dobiti na recepciji NKR-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na www.zka-rks.org i dostavljeni Odeljenju za upravljanje dokumentima na sledeću adresu: Naselje: Arberia, ul. „Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00 časova, obrazac i prateća dokumentacija mogu se dostaviti i putem e-pošte na rekrutimi@oagks.org ili poštom. Za detaljnije informacije možete kontaktirati tel. br. 038/606-004, lok. 1025.

**Napomena:**
Prijave poslate poštom, koje nose poštanski žig sa datumom isporuke izvršenim poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i biće uzete u razmatranje.

Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës "Nëna Tereze"
The Kosova Humanitarian and Charitable Society "Mother Tereza"
Humanitarno Dobrotvorno Udruzenje Kosova "Majka Tereza"
10 000 Prishtinë Rr.ULPIANA U1/1 pn. Tel:00381 38 542 864, Fax:542 869,
Web site: www.nenatereza.org e mail:ntereze@yahoo.com

# NJOFTIM PËR KONTRATË

***FURNIZIM***

*Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

**Data e përgatitjes së njoftimit: 15/07/*2026***

| **Nr i Prokurimit** | **MF** | **001** | **2026** | **121** |
|---|---|---|---|---|

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:
Shqip ☒ Serbisht ☐ Anglisht ☐

## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtar**: *SHHBK " Nëna Tereze"* | | |
| **Adresa Postare**: Mujë Krasniqi p.n. Ulpiana U1/1 | | |
| Qyteti Prishtinë | Kodi postar: 10000 | Vendi: Prishtinë |
| **Personi kontaktues**: Zef Shala | | Telefoni: 038-542-865 |
| Email: zefshala@hotmail.com | | Faksi: 038-542-869 |
| Adresa e Internetit (*nëse aplikohet*): | | www.Mhoterteresasociety.org |

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit Po ☐ Jo ☒

*Nëse po*, specifiko identitetin e të gjitha Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi.

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

### II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:**
**Furnizim me artikuj Ushqimor Joushqimor dhe Hygjenik (Pako Familjare) për 1000 familje ( 1000 pako )**

**II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit**
*(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)*

| ☐ **Punë** | ☒ **Furnizime** | ☐ **Shërbime** |
|---|---|---|
| ☐ Ekzekutim<br>☐ Plani dhe ekzekutimi<br>☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa | ☒ Blerja<br>☐ Qira financiare (lizing)<br>☐ Qira<br>☐ Blerje me këste<br>☐ Një kombinim i këtyre | |
| Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve<br>____________________<br>____________________ | Vendi kryesor i dorëzimit<br>**Sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktues** | Vendi kryesor i realizimit<br>____________________<br>____________________ |

**II.1.3) Njoftimi përfshinë**

Krijimin e kontratës publike kornizë Po ☐ Jo ☒

**II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë** *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator ☒

Kontrate publike kornizë me disa operator ☐

**Ekzekutimi i kontratës:**

Thirrje/Porosi ☒

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë ☐

**Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj 2 muaj**

**II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës**
**Furnizim me artikuj Ushqimor Joushqimor dhe Hygjenik (Pako Familjare) për 1000 familje ( 1000 pako)**

**II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):**
**01.00.00.00-1**

**II.1.7) Variantet pranohen** Po ☐ Jo ☒

**II.1.8) Ndarja në Pjesë** Po ☐ Jo ☒

*Nëse po*, tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

**II.I.9) Ne rast te një apo me shume pjesëve** *(nëse aplikohet)***:**

**Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:** ***[shëno numrin]***

**II.1.10) Informacione lidhur me pjesët** (*nëse aplikohen)*

| Nr. i pjesës | Përshkrimi i shkurtër |
|---|---|
| | |
| | |
| | |
| | |

**II.1.11) Vlera e parashikuar e kontratës: 47,000.00**

### II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm** *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*
**_ Furnizim me artikuj Ushqimor Joushqimor dhe Hygjenik (Pako Familjare) për 1000 familje ( 300 pako Prishtinë, 300 pako Mitrovicë, 200 pako Gjilan dhe 200 pako Pejë**

### II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj 2 *apo ditë 60* _________ (nga nënshkrimi i kontratës)
*apo*
Fillimi 15/08/2026
Përfundimi 15/10/2026

## NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

### III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

**III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit** Po ☐ Jo ☒

*Nëse po*, vlera e sigurisë së ekzekutimit _______ ose ___ % e vlerës së kontratës

**III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata** *(nëse aplikohet)*:
______________________________________________

**III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës** Po ☐ Jo ☒

*Nëse po,* përshkrimi i kushteve të veçanta

### III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

**III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:**
1. Certifikata e Regjistrimit të biznesit-Transport ndërkombëtar
2.Certifikaten e Numrit fiskal
3. Vërtetimin tatimor nga ATK **( vetpm për fituesin e kontratës**), ku vrehet se OE i ka përmbush obligimet nga tremujori i fundit ose i ka te programuara me rata obligimet e mbetura
4. Vërtetim nga Gjykata Themelore **( vetem për fituesin e kontrates)** ku shifet se Kompania dhe pronari i saj nuke jane ne ndonje procedur gjygjsore
5.Stafi profesional-menagjerial i Kompanisë- Organogrami

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1. 1.Dokumenti unik nga Ministria përkatëse
2.Dokumenti unik nga Institucioni përkatës
3. Dokumenti adekuat nga ATK-ja ( vetem per fituesin e kontrates)
4. Dokumenti adekuat nga Gjykata themelore ( vetem per fituesin e kontrates)
5.CV-te e stafit Menagjerial

**III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:**
1. Përvoja e gjertanishme ne tri vitet e fundit ne punë të ngjashme

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

Kontrata apo Referenca adekuate

**III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar**
1. Qarkullimi bankar ne tri vitet e fundit 2023-2024-2025

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1. Formulari i Deklarimit vjetor dhe pageses per tatimin ne te ardhurat e Korporatave CD

**III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional**
**1. Lista e Mjeteve Themelore në disponim ( Kamion transporti )**
**2. Depo-Magacionimi i mallrave**

*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
*1.* **Lejet e Qarkullimit të Automjeteve-Kamionëve të rexhistruara**
*2.* **Foto nga Hapsira e Depos**

### III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

**III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar** Po ☐ Jo ☒
***Nëse po,*** referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

**III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve** Po ☐ Jo ☐

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

*[kliko njërën dhe fshij te tjerat]*

**IV.1.1) Lloji i procedurës**

☒ **E hapur**

☐ **E kufizuar**

☐ **Konkurruese me negociata**

☐ **Kuotim i Çmimit**

**IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim** *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)*

Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

**IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave** *(procedurë konkurruese me negociata)*

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar **Po** ☐ **Jo** ☐

Autoritetet kontraktuese do të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata **Po** ☐ **Jo** ☐

IV.1.4) Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është : *[shëno numrin]*

IV.2) KRITERET E DHËNIES

*[Shëno në kutinë e duhur dhe fshij tjetrën]*

☒ **Çmimi më i ulët**

*apo*

☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

| Nën-kriteri | Pesha në % | Nën-kriteri | Pesha në % |
|---|---|---|---|
| 1) | | 5) | |
| 2) | | 6) | |
| 3) | | 7) | |
| 4) | | 8) | |

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

**IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë** **Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,***

Njoftim paraprak: ________________________________

Publikime tjera (*nëse aplikohen):* ________________

**IV.3.2) Kushtet për marrjen e *[dosjes së tenderit]***

Afati i fundit për pranimin e kërkesave për *[dosjen e tenderit]* : data **22/07/2026**_____

Dokumentet me pages **Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po***, çmimi ________________

Kushtet dhe metoda e pagesës: ________________________________

**IV.3.3) Afati i fundit për pranim të *[tenderëve]:***

***data 10/08/2026 koha 14:00 _______ vendi Prishtinë_***

**IV.3.4) Afati kohor për dorëzimin e *[tenderëve]* është shkurtuar:**

☐ po ☒ jo

***Nëse po***, jep arsyetim

**IV.3.5)** A është e nevojshme siguria e tenderit: **Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po***, vlera e sigurisë së tenderit ____________________

Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë ______ *apo* muaj ____________

**IV.3.6) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:**data: **10/08/2026 (30) ditë apo muaj ( një)_**

**IV.3.7) Takimi për hapjen e tenderëve:**

***data __10_/08/2026 koha 14:30_ vendi Prishtinë***

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

**Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.**

V.2) INFORMACIONET SHTESË

**Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.**

*Shto informacione tjera:[si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj]*

Bazuar në nenin 147 të Ligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, aksionarët e **BREZOVICA SKI ADVENTURE SH.P.K** me numër unik identifikues 811892935, me adresë në Trsenje nr.5, Brezovicë, Shtërpcë me datë **15/07/2026**, jepin këtë:

**NJOFTIM PËR ZVOGËLIM TË KAPITALIT**

I. **BREZOVICA SKI ADVENTURE SH.P.K.** ndryshohet sa i përket kapitalit, ashtu që zvogëlohet kapitali prej **110,000.00 €** (njëqind e dhjetëmijë euro) në **30,000.00 €** (tridhjetë mijë euro).

II. Obligohen zyrtarët e **BREZOVICA SKI ADVENTURE SH.P.K**, që këtë njoftim ta dërgojnë për publikim dy herë brenda një periudhe një javore, në të paktën një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.




## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fis Rogova nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Shani Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; 10,11,12,13 dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Dion Macula nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11 të gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

Saranda Karakushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 1,2,3,4 dhe diplomën e SH.M. Mjekësisë në Gjakovë.

- Bajram Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën nga kl, 6-9 të sh.m.u. “Rudolf Walther” Dejnë kk Gjakovë.

- Leart Vehapi shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Adizo SH.P.K. me nr. 812421460 bënë zvogëlim të kapitalit lëshuar nga ARBK.

- Jetmir Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. profesionale “Gjon Nikoll Kazazi” Gjakovë.

- Vlora I. Gashi B.I. Rogovë shpall të humbur numrin unik identifikues 811865552 lëshuar nga ARBK

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)


VIDAS
Llatte drink
2%
VIDAS
TAMËL
PRODHUAR ME FINESË DHE DASHURI
100% Fresh & Natural
VIDAS
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
VIDAS
JOGURT
VIDAS
DHALLË


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola


MEKA®
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA®
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES
95 g